



ODA E NOTERËVE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Notary Chamber of the Republic of Kosovo/ Notarska Komora Republike Kosova

Këshilli /Council / Savet

RAPORTI VJETOR

I ODËS SË NOTERËVE PËR VITIN 2019

10/01/2020

BAZA LIGJORE

Baza ligjore e këtij raporti:

Duke u bazuar në nenin 19, paragrafin 3, nën-paragrafin 16, të Statutit të Odës të Noterëve, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve *“përpilon raportin vjetor për punën e Odës”*. Ndërsa, neni 66, paragrafi 2, nën-paragrafi 7, i Ligjit për Noterinë parasheh se Kuvendi i Odës së Noterëve *“aprovon raportin vjetor të punës së Odës”*.

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve, në përputhshmëri me nenin 19, paragrafin 3, nënparagrafi 16, i Statutit të Odës të Noterëve, ka përgatitur raportin gjithëpërfshirës për vitin 2019 dhe do ta dorëzojë atë për aprovim në Kuvendin e Odës, i cili më pastaj do t'i dorëzohet Ministrisë së Drejtësisë.

Aprovimi i këtij raporti:

Duke u bazuar në nenin 66, paragrafi 3, të Ligjit për Noterinë, dhe nenin 11, paragrafin 1, të Statutit të Odës të Noterëve, vendimet e Kuvendit merren me shumicë të thjeshtë të votave (51 %).

Kurse, sipas nenit 11, paragrafi 4 të Statutit të Odës së Noterëve, vendimet e Kuvendeve si rregull merren me votim publik. Votimi i fshehtë kryhet vetëm me kërkesë nga të paktën $\frac{1}{4}$ (një e katërta) e pjesëmarrësve në Kuvend.

1. KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË NOTERËVE

Angazhimi i përgjithshëm i Këshillit Drejtues të Odës së Noterëve

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve, bazuar në nenin 20 të Statutit të Odës së Noterëve, gjatë vitit 2019 ka mbajtur 10 takime të rregullta mujore, në shumicën e të cilave prezent ishin edhe anëtarët e komisioneve tjera të Odës së Noterëve. Në takimet e rregullta mujore, përveç tjerash, janë shqyrtuar 27 kërkesa, 12 ankesa, 14 Njoftime dhe 45 urdhëresa, 6 përgjigje/sqarime, 1 Opinion Ligjor, 1 Aktgjykim dhe 4 Shkresa, gjithashtu janë nxjerrë dhe 57 vendime.

Në vazhden e punëve, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë; Ligjit Nr. 06/L-007 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore si dhe Ligjit Nr. 06/L-008 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 Për Trashëgiminë në Kosovë, me autorizim nga Kuvendi i Odës së Noterëve, mbajtur me datë 24.12.2018, u autorizua të ushtroj kërkesë tek institucioni i Avokatit të Popullit për iniciimin e vlerësimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së këtyre tri ligjeve.

Nga tri kërkesat e pranuar nga Avokati i Popullit, vetëm ajo e Ligjit për Noterinë u vlerësua si e pranueshme e për të cilën edhe u parashtrua edhe kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për iniciimin e vlerësimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë të Ligjit Nr. 06/L-010, ku më pas Gjykata Kushtetuese me datë: 24.05.2019, fillimisht vendosi që ta miratojë masën e përkohshme dhe të pezullojë menjëherë zbatimin e nenit 76, paragrafi 2, në lidhje me nenin 2, paragrafi 7 dhe nenin 22, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë; ndërsa me Aktgjykimin e datës 23.08.2019, konstatoi se nenet e kontestuara në kërkesën e Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin për Noterinë nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve për vitin 2019, ka organizuar gjithsej 5 Kuvende të rregullta:

➤ ***Kuvendi i mbajtur me 12.01.2019;***

- *Si pika të rendit të ditës së këtij Kuvendi, ishin diskutimi i Ligjit Nr.06/L-010 Për Noterinë; Ligjit Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore; dhe Ligjit Nr. 06/L-008 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë,*

ku edhe Kuvendi vendosi që ta autorizoj Këshillin Drejtues të Odës së Noterëve që përmes një kërkesë me shkrim të kërkoj një mendim/opinion ligjor nga Ministria e Drejtësisë lidhur me: Nenin 76 paragrafi 2, lidhur me Nenin 2 paragrafi 7, dhe Nenin 22, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, dhe Nenin 131.1, 133.1, 161, 161A të Ligji Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, sipas nesh në tërësi në kundërshtim me parimet dhe tërë dispozitat tjera të këtij ligjit. Gjithashtu Kuvendi mori vendim që përkohësisht të pezullohet zbatimi i nenit 41, paragrafi 1.3 dhe 1.4, të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, lidhur me punët juridike të këtij neni deri në marrjen e një vendimi tjetër nga organet kompetente. Gjithashtu, u vendos që përkohësisht të pezullohet zbatimi i Nenit 131.1, 133.1, 161 dhe 161A, të Ligji Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, deri në pranimin e mendimit/opinionit ligjor nga Ministria e Drejtësisë/organet kompetente, duke vazhduar kryerjen e procedurës trashëgimore sipas dispozitave ligjore të tjera të zbatueshme, kjo me qëllim të mos-ndërprerjes së këtyre procedurave në dëm të vet palëve, dhe krejt në fund u vendos që të vazhdohet ushtrimi i profesionit të noterit për të gjithë noterët në kuptim të nenit 76.2, deri në marrjen e vendimit meritor nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës apo të ndonjë interpretimi apo mendimi juridik paraprak pezullues lidhur me atë sa i përket interpretimit të nenit 76.2 të LNK.

➤ ***Në Kuvendin e mbajtur me datë 26.01.2019, u aprovuan dokumentet e poshtëshënuara të draftuara nga Këshilli Drejtues, si dhe u plotësua numri i anëtarët të Komisionit Disiplinor si kërkesë e Ligjit për Noterinë:***

- *Raporti Vjetor të Odës së Noterëve për vitin 2018, gjithashtu*
- *Statuti i Odës së Noterëve;*
- *Rregullorja e Punës së Kuvendit të Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Rregullorja për Procedurën Disiplinore për Noter,*
- *Rregullorja e Punës së Këshillit Drejtues së Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Rregullorja mbi Organizimin dhe Sistematizimin e Shërbimit Administrativ dhe Teknik në Odën e Noterëve, krejt këto të hartuara dhe të harmonizuara në pajtim me dispozitat e Ligjit 06/L-010 për Noterinë.*
- *Si dhe plotësimi i numrit të anëtarëve të Komisionit Disiplinor, ku sipas nenit 69, paragrafi 1, të Ligjit 06/L-010, kërkohet që ky Komisioni t'i ketë 5 anëtare*

dhe 5 zëvendës-anëtarë, me c`rast dhe për qëllim të funksionalizimit të menjëhershëm të këtij Komisioni, u propozuan dhe me aklamacion u zgjodhën: Noter Murtez Jahaj dhe Noter Hebib Livoreka anëtar të këtij Komisioni, ndërsa zëvendësanëtar Notere Alije Gusia, Noter Fatmir Tasholli dhe Noter Kolë Ramaj.

➤ **Kuvendi i mbajtur me datë 02.03.2019;**

- *Në këtë kuvend u diskutua Ligjit Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore dhe Opinioni Ligjor i pranuar nga Ministria e Drejtësisë, e që më pastaj u murr dhe një mendim juridik nga Kuvendi i Odës, ku u vendos të zbatohet Ligji Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore ashtu që të vazhdohet zhvillimi i procedurave trashëgimore pranë zyrave noteriale, duke e zbatuar përshtatshmërisht Nenin 161 të saj, kjo edhe me kërkesë dhe inicim të vet palëve, kjo me qëllim të mosndërprerjes së këtyre procedurave në interes të vet palëve, deri në marrjen e vendimit meritator edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.*
- *Në pjesën e dytë të Kuvendit Noterët informuan lidhur me Udhëzimet Administrative të hartuara në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.*

➤ **Kuvendi i mbajtur me datë 02.11.2019, ku u diskutuan/aprovuan:**

- *Në këtë kuvend u aprovua propozimi i znj. Sevdije Krasniqi, Kryesuese e Komisionit për identifikimin e lokacionit dhe parcelës së përshtatshme për ndërtimin e selisë së Odës së Noterëve, për blerjen e 2 parcelave të cilat gjenden në Z.K.K. Prishtinë, Z.K. Çagllavicë, me numër identifikimi 410/3 dhe 410/4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 7.74 ari, me një çmim momental prej 20.000 (njëzetmijë) euro për ari, si dhe u caktua që Sekretari i Odës së Noterëve të jetë si pikë kontakti me pronarin e paluajtshmërive deri në realizimin final të blerjes së këtyre parcelave.*
- *Në pjesën e dytë të ditës, u mbajt punëtorja me temë “Rastet praktike nga e drejta trashëgimore”, me ligjërues: z. Naxhi Zeqiri, Nënkryetar i Odës së Noterëve të Maqedonisë së Veriut dhe “E drejta trashëgimore mbi baza krahasuese me LNSH”, me ligjëruese Prof. Enkeleda Olldashi.*

➤ ***Kuvendi i mbajtur me datë 21.12.2019, ku u diskutuan/aprovuan:***

- *Raporti lidhur me Aktivitetet e Këshillit Drejtues të Odës së Noterëve, gjithashtu u caktua që DPZ Engin, nga Prizreni për punimin e vulave e thata, të cilat do të aplikohen nga data 03.01.2020, respektivisht në momentin që kjo kompani arrinë ti përfundoj, ku poashtu do të fillohet edhe lidhja e akteve sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR. 11-2019, për formën dhe mënyrën e përpilimit dhe shënimit të dokumenteve noteriale.*

Këshilli Drejtues i Odës kontribut të veçantë dha edhe në hartimin e Kodit Civil të Republikës së Kosovës, vazhdoi bashkëpunimin me Projektin e Financuar nga BE “Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve”; GIZ-in; Njësitin e Inteligjencës Financiare; Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit; Unionin Ndërkombëtarë të Noterisë; odat vendore dhe ato të rajonit, etj.

Këshilli Drejtues i Odës, po ashtu vazhdoi angazhimin edhe sa i përket mbikëqyrjes së punës në zyrat noteriale, me të cilin rast janë inspektuar 35 zyra noteriale në 15 komuna, për të cilat janë përgatitur procesverbale për noter, si dhe çdo 3 muaj ka përgatitur edhe raport për Ministrinë e Drejtësisë lidhur me këto kontrole.

2. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve ka qenë në bashkëpunimin të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë. Qysh në fillim të vitit 2019, duke pasur parasysh edhe dinamikën e punës për arsye të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, Ligjit Nr. 06/L-007 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore si dhe Ligjit Nr. 06/L-008 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 Për Trashëgiminë në Kosovë, Kryetari i Odës së Noterëve z. Aliriza Beshi u prit në takim nga Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri, ku temë diskutimi ishte zbatimi i pakos së tri ligjeve të hyra në fuqi; dhënia e një mendimi juridik nga Ministria e Drejtësisë lidhur me shqetësimet e paraqitura nga Oda e Noterëve në zbatim të dispozitave të caktuara të këtyre ligjeve; si dhe për angazhimet dhe detyrat e reja të cilat derivojnë nga këto ligje për Ministrinë e Drejtësisë dhe Odën e Noterëve. Ministri Tahiri e falënderoi Kryetarin Beshi për këtë takim si dhe të gjithë Noterët për punën e mirë të bërë deri më tani, ai e ritheksoi edhe njëherë se sistemi noterial në Kosovë është një shembull i suksesit. Z. Tahiri theksoi se Oda e Noterëve

është partneri kyç i Ministrisë së Drejtësisë në funksionalizimin e pakos së ligjeve, andaj edhe e kërkoi përkrahjen e Odës së Noterëve në këtë proces, përfshirë hartimin e akteve nënligjore të cilat derivojnë nga këto ligje, duke filluar me Ligjin për Noterinë, e në të cilin proces Ministri kërkoi përkrahje dhe angazhim nga Oda e Noterëve. Tema tjera të cilat u diskutuan në këtë takim ishin edhe ato rreth sigurimit të vulave të thata për noter, kërkesë nga ligji në fuqi, qasja e domosdoshme elektronike e zyrave noteriale në regjistrat publik, krijimi i regjistratit të testamenteve i cili do të mirëmbahet nga Oda e Noterëve dhe regjistrave të tjerë të paraparë me këtë ligj, aktet e brendshme të Odës së Noterëve, gjeneratat e reja/kandidatët në sistemin noterial.

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, nga data 01 deri 03 Shkurt 2019, në Pejë, mbajti punëtorinë për hartimin e Udhëzimeve Administrative që derivojnë nga Ligji për Noterinë Nr. 06/L-010. Sipas agjendës së punëtorisë, u punua në

- *U.A. për organizimin dhe mënyrën e punës së noterëve;*
- *U.A. për kushtet e zyrës noteriale, hapësirës dhe pajisjet;*
- *U.A. për përmbajtjen, formularët, mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së dokumenteve noteriale, librave dhe regjistrave;*
- *U.A. për procedurën disiplinore për noter;*
- *U.A. për formën dhe mënyrën e përpilimit të dokumentit, shenjëzimit dhe lëshimit të dokumentit noterial.*

Në këtë punëtori nga Oda e Noterëve morën pjesë Kryetari i Odës z. Aliriza Beshi, z. Shpend Haskaj, Kryesues i Komisionit për aftësim profesional të Noterëve në ONK dhe Sekretari i Odës z. Erdon Gjinolli, ndërsa nga Ministria e Drejtësisë morën pjesë znj. Fadilete Hoxha, Udhëheqëse e Divizionit për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, Departamenti për Profesione të Lira; znj. Burbuqe Spahija, Zyrtare e Lartë Ligjore për Noteri në Departamentin për Profesione të Lira dhe z. Isuf Jahmurataj, Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit.

Me qëllim të finalizimit të Udhëzimeve Administrative, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë organizoi vizitën studimore njëditore në Odën e Noterëve të Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave në lidhje me digjitalizimin e sistemit noterial, sigurinë e të dhënave digjitale, emërimin e zëvendës-noterëve, procedurën disiplinore, dhe tema të tjera që lidhen me noterinë. Fillimisht u mbajt një takim pune me përfaqësues nga Oda e Noterëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut e udhëhequr nga Presidenti i kësaj Ode z. Vasil Kuzmanoski. Pas takimit, delegacioni mori pjesë në seminarin e organizuar nga Oda e Noterëve të Maqedonisë së Veriut për noterët e tyre, si dhe në

fund, delegacioni vizitoi zyrën e Noterit Muamer Shehu në Shkup, ku u prezantua sistemi digjital i noterisë në Maqedoninë e Veriut, demonstrim hap pas hapi se si kryet regjistrimi në sistemin e Agjencisë për Prona të Paluajtshme direkt nga zyra noteriale.

Gjithashtu, Këshilli Drejtues i Odës, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë organizoi vizitë në Odën e Noterëve të Republikës së Malit të Zi. Qëllimi i vizitës ishte po i njëjti, shkëmbimi i përvojave në lidhje me sistemin noterial, aktet nënligjore, emërtimi i ndihmës-noterëve, rregulloret e brendshme të Odës si dhe tema të tjera që lidhen me noterinë. Fillimisht përfaqësuesit e Odës së Noterëve dhe ata të Ministrisë së Drejtësisë u pritën në një takim nga Bordi i Odës së Noterëve të Malit të Zi, ku z. Branislav Vukicevic, Kryetar i Odës së Noterëve të Malit të Zi çmoi interesimin e shprehur nga zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë që përmes shkëmbimit të përvojave të arrijnë t'i nxjerrin udhëzime të aplikueshme e që do t'i shërbenin si noterëve ashtu edhe shtetasve të Kosovës.

Pas këtyre vizitave, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Noterëve vazhduan takimet rreth finalizimit të udhëzimeve, të cilat tani janë nënshkruar nga Ministri Tahiri dhe janë në fuqi.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Noterinë, Ministria e Drejtësisë nxorri Udhëzimin Administrativ MD-NR. 01/2019 për mënyrën e dhënies dhe programin e Provimit për Noterinë, dhe më pas shpalli konkursin për të gjithë kandidatët e interesuar të aplikojnë për dhënien e provimit për noter dhe më pas insistimet e MD-së edhe në emërimin e noterëve të rinj. Ajo që duhet theksuar është edhe hapja e konkursit për emërimin e 79 noterëve të rinj.

Oda e shqetësuar me procesin e provimit të organizuar dhe konkursin e shpallur për 79 pozita, në dy raste me shkrim reagoi dhe shprehi shqetësimin e saja, por edhe në takimet që i pati me Ministrin e Drejtësisë, takime këto të mbajtura me kërkesë të vet Ministrit, me datë 16 dhe 18 Tetor 2019. Edhe pse Oda kishte dhe ka nevojë për noter të rinj, së paku në komunat të cilat janë pa noter si dhe aty ku tashmë janë pensionuar apo pritët të pensionohen, procedura e licencimit u kundërshtua dhe po vazhdon të kundërshtohet nga ambasadat dhe shoqëria civile, dhe kjo veçanërisht sa i përket ligjshmërisë së emërimit pas dorëheqjes së qeverisë, si qeveri në largim.

Oda e Noterëve shqetësimet dhe reagimet e saja me shkrim i bëri publike edhe në ueb-faqen e sajë, por edhe në takimet e organizuara me akterët e interesuar, ku vlen të theksohet takimi i datës 06.11.2019, i mbajtur mes Odës së Noterëve të Kosovës, Unionin Ndërkombëtar të Noterisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ambasadorit Gjerman në

Kosovë dhe përfaqësues nga Shoqëria Civile, por edhe takimi i datës 26.11.2019 në Odë me Zëvendës-ambasadorin Gjerman z. Jan-Axel Voss, ku mes të tjerash u insistua në iniciimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Noterinë në këtë pjesë, pasi që vet ky ligj me këto kritere të reja dhe me procedurë të centralizuar ka sjellë deri në këtë gjendje.

Po ashtu, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve ka raportuar edhe rreth organizimit të trajnimeve për noter, për punëtorë të zyrave noteriale, si dhe për rastet, (kërkesat/ankesat) e ngritura nga qytetarët në Ministrinë e Drejtësisë në raport me noterët.

Këshilli i Odës së Noterëve i shoqëruar dhe i ndihmuar edhe nga noterë tjerë morën pjesë edhe në takimet e rregullta të organizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Projekti “Mbështetje Kodit Civil” i financuar nga BE, rreth hartimit të Kodit Civil të Kosovës.

Pjesëmarrja në takimet e rregullta mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Projekti “Mbështetje Kodit Civil” i financuar nga BE, rreth hartimit të Kodit Civil të Kosovës

- 18.01.2019, Takim i Grupit Punues për Kodin Civil, shpjegim i draftit përfundimtar para procedimit;
- 19.03.2019, Takimi me Grupit Punues për Kodin Civil;
- 20.03.2019, Takim me ekspertin e projekt Kodit Civil, znj. Jadranka Vojinović, “zhvillimi i një katalogu të moduleve të trajnimit të kodit civil si dhe mundësitë për zhvillimin e platformës elektronike”;
- 17.04.2019, Me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, takimi përfundimtar i Grupit Punues për Kodin Civil, procesimi i të gjitha komenteve të pranuar gjatë fazës së konsultimeve;
- 17.04.2019, Takimi me ekspertin e projekt Kodit Civil, znj. Jadranka Vojinović, “zhvillimi i një katalogu të moduleve të trajnimit të kodit civil si dhe mundësitë për zhvillimin e platformës elektronike”;

- *27-29 Maj 2019, Vizita studimore e organizuar nga Projekti i financuar nga BE “Mbështetje Kodit Civil të Kosovës”, në Hagë të Holandës. Ku përveç ONK-së, pjesëmarrës ishin dhe Deputet nga Parlamenti i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Gjyqtar, të cilët kanë qenë kontribuues gjatë hartimit të Kodit Civil në Kosovë;*
- *18.06.2019, Pjese e panelit të Kodit Civil: Paneli Intervistues për rekrutimin e praktikantëve;*
- *07.10.2019, Takim me ekspertin e projekt Kodit Civil, znj. Jadranka Vojinović, koordinimi i trajnimeve të kodit civil;*
- *16.10.2019, Takim me Ministrin e Drejtësisë;*
- *18.10.2019, Takim me Ministrin e Drejtësisë;*
- *12.11.2019, Takimi me Ministrinë e Drejtësisë, diskutimi përfundimtar i Udhëzimeve Administrative, të cilat derivojnë nga Ligji i Noterisë;*
- *07.12.2019, Tryezë e rrumbullakët me Projektin e Kodit Civil, me temë mbështetje e Noterëve lidhur me risitë e Kodit Civil;*
- *14.12.2019, Tryezë e rrumbullakët me Projektin e Kodit Civil, me temë mbështetje e Noterëve lidhur me risitë e Kodit Civil;*
- *Si dhe bashkëpunimi me Departamentin për Profesione të Lira, dorëzim-pranimi i lëndëve të Noter Enver Morina, Notere Bahrija Skenderi, Noter Ibrahim Elshani dhe Noter Isak Ademi me rastin e pensionimit, etj.*

3. Bashkëpunimi me projektin e financuar nga BE “Mbështetje Profesioneve të Lira dhe Odës së Avokatëve”.

Oda Noterëve edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimin me Projektin e Financuar nga BE “Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve”, gjatë kësaj kohe projekti ka ndihmuar në organizimin e një trajnimi për Noter.

- Trajnimi me temë: *“Ekzekutueshmëria e akteve noteriale sipas Ligjit të ri për Noterinë, klauzola e ekzekutueshmërisë”, respektivisht “Akti noterial dhe përshtatshmëria e detyrimit përmbartimor për ekzekutim” dhe “disa aspekte praktike të ekzekutueshmërisë së akteve noteriale”, me ligjërues, z. Aliriza Beshi, Kryetar i Odës, z. Shpend Haskaj, Kryesues i Komisionit për Aftësim Profesional të Noterëve, dhe z. Sefadin Blakaj, Noter, ndërsa i ftuar në këtë trajnim ishte dhe Nënkryetari i Odës së Noterëve të Maqedonisë së Veriut z. Naxhi Zeqiri, i cili shpjegoi ekzekutueshmërinë e akteve noteriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.*

Aktivitete tjera të organizuara nga projekti.

- *23.01.2019, Mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të financuar nga BE “Mbështetje profesioneve të lira ligjore & Odës së Avokatëve”;*
- *25.02.2019, Takim me Ekspertin e Projektit të financuar nga BE, z. Erdi Pirana;;*
- *16.04.2019, Mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të financuar nga BE “Mbështetje profesioneve të lira ligjore & Odës së Avokatëve”;*
- *17.05.2019, Prezantimi i Rezultateve/Statistikave nga Raporti i dytë mbi Përceptimin e Publikut për Profesionet e Lira Ligjore / Projekti i BE-së “Mbështetje PLL dhe OAK”;*
- *11.07.2019, Mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të financuar nga BE “Mbështetje profesioneve të lira ligjore & Odës së Avokatëve”;*
- *04.09.2019, Takimit të Përbashkët mbi Aspektet Kryesore të Bashkëpunimit, Koordinimit institucional mes PLL-ve dhe Komunikimit të PLL-ve;*
- *17.09.2019, Takim me Projektin e financuar nga BE, mbi modalitetet paraprake të disa moduleve për trajnimin e noterëve të rinj;*

- 22.05.2019, Takim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë, Odës së Noterëve, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjyqtarëve dhe noterëve, mbi disa sfida për zbatimin e Ligjit të ri për Noterinë, Ligjit të ndryshuar për Trashëgiminë, Ligjit të ndryshuar për Procedurën Jo-Kontestimore dhe Ligjin e ndryshuar për Familjen.
- 31.10.2019, Takim i Përbashkët mbi modalitetet paraprake të disa moduleve për trajnimin e noterëve të rinj, "Prezantimi i modaliteteve paraprake të disa moduleve për trajnimin e noterëve të rinj" nga Z. Sefedin Suljevic, Ekspert i Lartë, Projekti i BE-së;
- 07.11.2019, Mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të financuar nga BE "Mbështetje profesionale të lira ligjore & Odës së Avokatëve";
- 21.11.2019, Takim i Përbashkët i Projektit të financuar nga BE, Akademisë së Drejtësisë, Zyrës së Bashkimit Evropian, Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Noterëve mbi Dizajnimin/Hartimin e disa Moduleve për Trajnimin e Noterëve të rinj.
- 18.12.2019, Takim i Përbashkët mbi modalitetet paraprake të disa moduleve për trajnimin e noterëve të rinj, "Prezantimi i modaliteteve paraprake të disa moduleve për trajnimin e noterëve të rinj" nga Z. Sefedin Suljevic, Ekspert i Lartë, Projekti i BE-së;

4. Bashkëpunimi me GIZ

Oda e Noterëve të Kosovës gjatë këtij viti e ka vazhduar bashkëpunimin me Fondin e Hapur Rajonal GIZ, posaçërisht vlen të theksohet pjesëmarrja në:

- 07.11.2019, Punëtorinë Kick-off për projektin "Forcimi i fuqizimit ekonomik të grave", mbajtur në Tiranë, dhe

- *08.11.2019, Konferencën PIL, Tiranë, Konferenca e 16-të Rajonale e së Drejtës Ndërkombëtare Private (PIL): "Sistemi i bashkëpronësisë të bashkëshortëve/bashkëjetuesve sipas te Drejtës Ndërkombëtare Private ne BE".*

5. Bashkëpunimi me Njësinë e Inteligjencës Financiare

Sikurse edhe në vitet e kaluara, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve ka bashkëpunim shumë të ngushtë me Njësinë e Inteligjencës Financiare, ku më poshtë janë cekur pjesëmarrja në takimet e ftuara nga NJIF-K:

- *5 dhe 6 mars 2019, PECK II punëtori lidhur me mbikëqyrjen e bazuar në rrezik lidhur me inspektimet e AML/CFT;*
- *19.03.2019, Takim i zyrtarëve të Njesisë për Inteligjencë Financiare me Kryetarin e Odës së Noterëve;*
- *03.04.2019, Njësia për Inteligjencë Financiare të gjithë noterëve u hapi username/llogari përmes së cilës mund të raportojnë direkt lidhur me transaksionet të dyshimta gjatë punës së tyre;*
- *17-19 prill 2019 pjesëmarrje në trajnimin për zbatimin e Udhëzuesit dhe Doracakut të ri për hartimin e koncept dokumenteve;*
- *19.07.2019, Takim i grupit punues për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për Pronësinë Përfituese dhe dokumentin teknik që përmban Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si përgjigje ndaj raportit të vlerësimit për Kosovën të përgatitur nga Eksperti i Këshillit të Evropës në kuadër të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK II);*
- *13.08.2019, Takim i grupit punues për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për Pronësinë Përfituese dhe dokumentin teknik që përmban Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si përgjigje ndaj raportit të vlerësimit për Kosovën të përgatitur nga Eksperti i Këshillit të Evropës në kuadër të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK II);*
- *15.08.2019, Takim i grupit punues për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për Pronësinë Përfituese dhe dokumentin teknik që përmban Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si përgjigje ndaj*

raportit të vlerësimit për Kosovën të përgatitur nga Eksperti i Këshillit të Evropës në kuadër të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK II);

- *26.11.2019, Takim i grupit punues për hartimin e Projekt - Udhëzimit Administrativ për Pronësinë Përfituese.*

6. Takime të tjera të organizuara në të cilat morri pjesë Këshilli Drejtues i ONK-së:

- *24.01.2019, Takim me z. Avni Ahmetin, Kryeshef i Agjencionit Kadastral të Kosovës;*
- *08.03.2019, Takimi me znj. Rrezearta Reka, Projekti për Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion, në kuadër të zyrës së UNDP-së në Kosovë, “Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në sektorin e noterisë në Kosovë”;*
- *11.03.2019, Takimi me znj. Rrezearta Reka, Projekti për Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion, në kuadër të zyrës së UNDP-së në Kosovë, “Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në sektorin e noterisë në Kosovë”;*
- *11.03.2019, Takimi me USAID dhe Gazetën Zyrtare, “Krijimi i hapësirës për postimin e njoftimeve në Gazetën Zyrtare për Noterët në zbatim të nenit 32 (161), të Ligjit Nr. 06/L-007 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore”;*
- *26.03.2019, Takim me ARC;*
- *08.05.2019, Takimi me znj. Jayashree Srinivasan dhe Liliya Bulgakova nga Projekti i të Bërit Biznes, Banka Botërore, lidhur me pyetësin “Regjistrimi i Pronës”.*
- *20.05.2019, Takimi me znj. Znj. Joanna Brooks, Brooks, Projekti për Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion, në kuadër të zyrës së UNDP-së në Kosovë, “Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në sektorin e noterisë në Kosovë”;*

- 07.06.2019, Takim konsultues institucional në Agjensionin Kadastral të Kosovës, për komponentët e projektit për regjistrimin e pronës në kadastër dhe për infrastrukturën e informacioneve hapësinore;
- 16.09.2019, Takimi i përbashkët me UNDP, prezantimi i Draft - Raportit nga Projekti për Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion, në kuadër të zyrës së UNDP-së në Kosovë, "Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në sektorin e noterisë në Kosovë";
- 18.09.2019, Takim me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Ekrem Mustafa, lidhur me plotësimin e aplikacionit për qasje në Regjistrin Civil;
- 25.09.2019, Promovimi i Projektit nga IMG, Kuvendi i RKS dhe Ambasada e Norvegjisë, "Zhvillimi i shërbimit informativ për Ligje";
- 27.09.2019, Takim në Agjensionin Kadastral të Kosovës, Takimi i radhës i Grupit Punues për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi;
- 07.10.2019, Takimi z. Sami Mazreku, Drejtor i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës;
- 12.10.2019, Trajnim për Odën e Përmbauesve, "Dokumenti ekzekutiv noterial";
- 23.10.2019, Takim me znj. Ivana Bojic, nga Banka Botërore, "Vlerësim i ndihmës së Bankës Botërore për administrimin, planifikimin dhe zhvillimin e tokës";
- 29.10.2019, Promovimi i raportit nga UNDP, nga Projekti për Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korrupsion, në kuadër të zyrës së UNDP-së në Kosovë, "Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në sektorin e noterisë në Kosovë";
- 06.11.2019, Takimi mes Odës së Noterëve të Kosovës, Unionin Ndërkombëtar të Noterisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ambasadorit Gjerman në Kosovë dhe përfaqësues nga Shoqëria Civile.

- *26.11.2019, Pjesëmarrja në eventin e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Kosovë për nderë të festës së 28 Nëntorit;*
- *Pjesëmarrja në 20 Vjetorin e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.*

7. Bashkëpunimi me UINL-në dhe Odat e Noterive,

Oda e Noterëve si anëtare e rregullt Unionit Ndërkombëtar të Noterisë UINL-së, ka vazhduar edhe këtë vit pjesëmarrjen e saj në takimet e organizuara nga UINL, si dhe me kërkesë të tyre ka dhënë kontributin e saj përmes pyetësorëve të dërguar për përgatitjen e materialeve për këto takime.

Oda e Noterëve gjatë këtij viti morri pjesë në:

- *Seancën 5-të plenare të Komisionin Evropian të Noterisë CAE, UINL, për legjislacionin 2017-2019, mbajtur në datat 05-06 Prill 2019, në Londër të Anglisë;*
- *Konferencën e 31-të Evropiane të Noterisë, me temë “Evropa si një parim unifikues – ambicie dhe realizim”, mbajtur me datë 25-26 Prill 2019, Salzburg të Austrisë;*
- *Konferencën “Ditët e Notariatit Turk”, mbajtur me datë 04.05.2019, në Ankara të Turqisë;*
- *Kongresin e 48të të Unionit të Noterëve të Turqisë, mbajtur me datë 14.06.2019, në Ankara të Turqisë;*
- *Konferencën ndërkombëtare kushtuar 25 vjetorit të rivendosjes së sistemit Noterial në Republikën e Kroacisë, e mbajtur në datat 25 dhe 26 Tetor 2019, në Zagreb të Kroacisë;*
- *Po ashtu vlen të theksohet punësoria e përbashkët e organizuar me Dhomën Kombëtare të Shqipërisë, në Durrës, datë: 02.11.2019.*

8. Bashkëpunimi me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit ASHI

Komisioni i Odës së Noterëve gjatë këtij viti ka mbajtur takime të vazhdueshme me Drejtoratin për Zhvillimin e e-Qeverisjes në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim të jetësimit të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Oda e Noterëve dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, ashtu që zyrave noteriale bazuar në përmbajtjen e këtij memorandum t'i lejohet qasja në këtë regjistër vetëm me numër personal të palëve.

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Odën e Noterëve të Kosovës, pas përpjekjeve dhe takimeve të zhvilluara me zyrtarët e ARC-së, përmes një shkrese zyrtare dërguar Agjencisë së Regjistrimit Civil kërkuan që edhe një herë ky Agjencion t'i merr përbazë kërkesat e vazhdueshme të Odës së Noterëve rreth plotësimit të aplikacionit tani të instaluar nëpër zyre noteriale, ashtu që të dhënat nga ky regjistër të mund të gjenerohen vetëm me numër personal të palës dhe jo edhe me numër serik të certifikatave të fundit siç është aktualisht. Në përgjigjen e tij, Drejtorit i këtij Agjencioni z. Bekim Hoxha, gjatë takimit të përbashkët të organizuar me Ministrin e Punëve të Brendshme, theksoi se shumë shpejtë ky Agjencion do ta pranojë një donacion nga Banka Botërore, ku përveç tjerash me këtë donacion do të plotësohet/përmbushet edhe kërkesa e Odës së Noterëve për këtë regjistër.

9. Përpunimi i statistikave dhe mbikëqyrja e pagesës së kontributit të noterëve

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve mbanë shënime statistikore lidhur me numrin e lëndëve të kryera në baza mujore për secilën zyre noteriale. Në përgjithësi të dhënat në fjalë janë grumbulluar nga Administrata e Odës së Noterëve bazuar në formularin e plotësuar në baza mujore nga secili noter "Deklarimi mbi Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme". Këshilli Drejtues i Odës, gjithashtu mbikëqyrë dhe mbanë evidencën e pagesave mujore në emër të kontributit të noterëve për Odën në vlerë prej 2% nga bruto qarkullimi mujor.

10. Aktivitete dhe vendime tjera:

Vlen të theksohet se pas tërmetit në Republikën e Shqipërisë, ku u shkaktuan viktima në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve morri iniciativën për ndarjen e një fondi për të prekurit nga ky tërmet. Pas marrjes së pëlqimit nga noterët, Këshilli Drejtues ndau një fond prej 10.000 €, si ndihmë për të

prekurit në Shqipëri, ndërsa falë organizmit të noterëve u vendos që të kontribuohet edhe vullnetarisht dhe të ndihmohet edhe Familja Abazi nga Gjilani, 2 djemtë e së cilës humbën jetën në Durrës me rastin e tërmetit. Nga kontributi vullnetar i Noterëve u grumbulluan edhe 4.000 € të tjera ku Këshilli Drejtues vendosi që shuma prej 12.000 € (Dymbëdhjetëmijë Euro), nga e cila shumë 10.000 € (Dhjetëmijë euro) ishin ndarë nga buxheti i Odës së Noterëve dhe 2.000 € (Dymijë Euro) të tjera nga kontributi vetenak i disa noterëve, të mbledhura/grumbulluara po në këtë llogari me qëllim që të ndihmohen të prekurit nga tërmeti në Shqipëri, e cila shumë u transferua në llogarinë bankare të Dhomën Kombëtare të Noterisë së Shqipërisë, si dhe shuma e mbetur nga kontributi vetenak i disa noterëve edhe atë në vlerë prej 2.000,00 € (Dymijë Euro) iu dërgua familjes Abazi nga Gjilani nga një delegacion i ONK-së, i prirë nga Nënkrjetari i Odës së Noterëve z. Fatmir Halimi me c`rast edhe e vizituan Familjen Abazi.

Pas Aprovimit të marrë nga Kuvendi i Odës së Noterëve, mbajtur me datë: 02.11.2019, Këshilli Drejtues vendosi që t'i blejë parcelat me Nr. P-71914075-00410-3, në sipërfaqe prej 378m² dhe P-71914075-00410-4, në sipërfaqe prej 390 m², në total 768m², të cilat gjenden në ZKK Prishtinë, Zona Kadastrale dhe vendi i quajtur Çagllavicë, me pronar Agron Nazmi Berisha, në shumën prej 20.000 € (Njëzet mijë euro) për 1 ari, e në total prej 153.600,00 €. Përkundër se shpallja publike ishte e hapur për 14 ditë rresht, me përjashtim të ofertuesit z. Agron Berisha nuk pati ofertues të tjerë, andaj në zbatim të vendimeve të Kuvendit, Këshillit Drejtues si dhe Komisionit për identifikimin dhe blerjen e parcelave, në zbatim të vendimit të Kuvendit, me datë 06.12.2019, lidhi kontratë mbi shitblerjen e parcelave, mes Agron Nazmi Berisha si shitës dhe Oda e Noterëve të Kosovës, e përfaqësuar nga znj. Sevdije Krasniqi, si blerës.

10. Financat

Buxheti i Odës së Noterëve është miratuar nga Kuvendi i Odës, me datë 22 dhjetor 2018, ku ishte paraparë që për vitin 2019 buxheti i Odës të jetë rreth 145,000.00 Euro (Njëqind e dyzet e pesë mijë euro). Në vija buxhetore janë aprovuar/lejuar shpenzimet për vitin 2019.

Sa i përket buxhetit, saktësisht financave, në përgjithësi është shpenzuar duke u bazuar në suazat e buxhetit të miratuar. Për çdo shpenzim që është bërë, paraprakisht është nxjerrë Vendim i shkruar nga Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve. Për të gjitha shpenzimet që janë bërë, ekzistojnë dokumentet/faturat që tregojnë shpenzimet dhe janë arkivuar në Odën e Noterëve.

Gjatë këtij viti, Komiteti për Auditim i ka audituar financat e Odës për periudhën 01 dhjetor 2018 deri me 01 dhejtor 2019, sipas metodës faturë për faturë, duke i audituar në tërësi të gjitha shpenzimet e ONK-së.

Tabela e mëposhtme tregon vijat buxhetore të aprovuara nga Kuvendi dhe daljet sipas këtyre vijave për vitin 2019, deri me 31.12.2019:

Nr.	Emërtimi i vijave buxhetore të aprovuara në Kuvendin e Odës, datë 24.12.2018, për vitin 2019	Shuma e Aprovuar	Daljet në vija buxhetore 2019
1.	Pagat dhe kontributet	29.000,00 €	30.930,02 €
2.	Qiraja e zyrës së Odës së Noterëve	7.000,00 €	6.593,36 €
3.	Energjia elektrike, interneti, telefoni dhe mirëmbajtja e selisë	3.000,00 €	1.081,78 €
4.	Pajisje për Zyrë (komputera, printera, skaner, fotokopje, etj.)	1.000,00 €	669,00 €
5.	Organizimet e trajnimeve për noterët dhe stafin e tyre, konferenca si dhe organizime tjera	25.000,00 €	11.819,84 €
6.	Mirëmbajtja e Eëb-faqes	500,00 €	499,00 €
7.	Realizimi i kampanjës vetëdisuese për shërbimin noterial	2.000,00 €	1.000,00 €
8.	Artikuj për zyre (regjistra, tonera, letër, etj.)	2.000,00 €	1.978,63 €
9.	Shpenzimet e Komisioneve	6.500,00 €	5.715,35 €
10.	Anëtarësia vjetore për Unionin Ndërkombëtar të Noterëve	2.500,00 €	2.134,71 €
11.	Përfaqësimi i Odës në organizimet ndërkombëtare (misionet ndërkombëtare)	25.000,00 €	16.180,05 €
12.	Mirëmbajtja vjetore e eëb aplikacionit për regjistrimin e lëndëve noteriale	5.000,00 €	4.810,00 €
13.	Mirëmbajtja e veturës së Odës (Sigurimi, kontrollimi teknik, servisimi, karburanti) etj.	2.000,00 €	1.609,07 €
14.	Mirëmbajtja e kontabilitetit	1.500,00 €	1.300,00 €
15.	Ndihmë financiare për Noter në rast nevojë	4.000,00 €	2.900,00 €
16.	Shpenzimet investuese, mjete me të drejtë rialokimi	29.000,00 €	19.216,85 €
17.	Shuma Totale e Buxhetit për vitin 2019	145.000,00 €	-
18.	Daljet për vitin 2019		108.437,66 €

Ndërsa, tabela e mëposhtme tregon pasqyrën financiare të mjeteve të bartura nga viti paraprak, të hyrat për vitin 2019, të dalat sipas vijave buxhetore për vitin 2019, të dalat me vendim të kuvendit si dhe bilancin total të gjendjes financiare të Odës së Noterëve deri me datë 31.12.2019.

	Pasqyrë financiare nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019	
1.	Të bartura nga viti 2018	359.250,72 €
2.	Të hyra në vitin 2019	192.461,36 €
3.	Të dala në vitin 2019	108.437,66 €
4.	Blerja e parcelave për ONK-në, sipas vendimit të Kuvendit	153.600,00 €
5.	Bilanci i llogarisë 2019	289.674,42 €

2. KOMISIONI DISIPLINOR

Komisioni Disiplinor, si organ i shkallës së parë që vendos për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Odës, në vitin 2019 ka mbajtur 7 takime, ku ka shqyrtuar 6 raste.

Fillimisht, Komisioni e ka rishikuar aspektin formal të ankesave me qëllim të përcaktimit nëse ato janë të afatshme dhe të lejuara. Në pajtim me Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.6/2010 për Procedurën Disiplinore për Noter, 4 ankesa janë hudhur poshtë si të pabazuara dhe 2 ankesa janë refuzuar si të palejueshme.

Në të gjitha takimet e komisionit është mbajtur procesverbal, i cili në fund është nënshkruar nga të gjithë të pranishmit. Vendimet e Komisionit Disiplinor janë marr me koncenzus të plotë të anëtarëve të këtij komisioni.

3. KOMITETI I AUDITIMIT

Komiteti për Auditim e Odës së Noterëve sipas detyrës zyrtare ka audituar aktivitetet ekonomike dhe menaxhuese të Odës së Noterëve për vitin 2019, konkretisht periudhën 01 dhjetor 2018 – 01 dhjetor 2019, si dhe ka shqyrtuar dhe siguruar komente për këtë raport për sa u përket aktiviteteve të Odës.

Përgjegjësi e Komitetit për Auditimin e Odës së Noterëve është shprehja e opinionit rreth pasqyrave financiare (pasqyrat e burimeve dhe përdorimi i fondeve), ku qëllim kryesor është arritja e sigurisë së arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara.

Komiteti për Auditim të Odës së Noterëve, me datë 11.06.2019 dhe 12.12.2019 i ka audituar aktivitetet ekonomike dhe menaxhuese të Odës së Noterëve të Kosovës. Mënyra e auditimit gjatë vitit 2019 është realizuar sipas metodës faturë për faturë, ku Komiteti i Auditimit i ka verifikuar të gjitha daljet në Odën e Noterëve, përputhshmërinë e tyre me vijat buxhetore të aprovuara nga Kuvendi i Odës së Noterëve, arsyetimet për secilën pagesë, qofshin ato fatura të rregullta, apo forma të tjera të arsyetimit, siç janë vendimet apo procesverbalet e Këshillit Drejtues të ONK-së.

Sipas Komitetit, bazuar në auditimin e kryer për vitin 2019, është konstatuar se Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve ka realizuar buxhetin në përputhje me planifikimin e detajuar të buxhetit për vitin 2019, duke siguruar dëshmi dhe arsyetim për çdo shpenzim/pagesë të realizuar në pajtim me buxhetin e vitit 2019. Me përjashtim të pikës 1 të Buxhetit të aprovuar nga Kuvendi i Odës së Noterëve, ku ka tejkalim të vijës buxhetore, e njejtat ndërkohë e plotësuar nga pika 16 - mjete me të drejtë rialokimi, asnjëherë pa e cenuar shumën e buxhetit të aprovuar, të gjitha shpenzimet tjera janë realizuar në përputhje me parashikimet buxhetore për vitin 2019.

Andaj, duke u bazuar në të gjeturat e të gjitha lëndëve të audituara Komiteti për Auditim konstatoi se buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Odës së Noterëve është realizuar në përputhje me planifikimin e detajuar të buxhetit për vitin 2019, gjithashtu Këshilli i është përmbajtur rregullave mbi menaxhimin e financave duke aplikuar marrjen e tri ofertave, prej të cilave përzgjedhja është bërë në bazë të çmimit më të lirë, me përjashtim të rasteve kur lokacioni ka qenë i vendosur me Vendim të arsyetuar të Këshillit Drejtues të ONK-së.

4. KOMISIONI PËR AFTËSIMIN PROFESIONAL TË NOTERËVE

Bazuar në nenin 38, paragrafi 3 të Statutit të Odës të Noterëve, Komisioni për Aftësimin Profesional të Noterëve, për vitin 2019 ka organizuar 4 tajnime për Noter dhe 1 për punëtorë të zyreve noteriale. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti Oda e Noterëve ka gëzuar dhe mbështetje edhe nga ana e Projektit për Mbështetje të Profesioneve të Lira në Kosovë, i cili projekt ndihmoi si në mbështetje organizative dhe financiare, poashtu edhe në sjelljen e ekspertëve të huaj për këto organizime.

Tema të trajnimeve të cilat ishin përzgjedhur për këtë vit nga Komisioni për Aftësimin Profesional të Noterëve ishin:

- Më datë 12.01.2019, është mbajtur trajnimi për Noter, me temë "Ligji Nr.06/L-010 Për Noterinë; Ligji Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore; dhe Ligji Nr. 06/L-008 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, me ligjërues z. Aliriza Beshi, Kryetar i Odës së Noterëve dhe z. Shpend Haskaj, Kryesues i Komisionit për aftësim profesional të noterëve;
- Më datë 02.03.2019, është mbajtur trajnim mbi zbatimin e dispozitave të ndryshuara të Ligjit Nr.06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, z. Aliriza Beshi, Kryetar i Odës së Noterëve dhe z. Shpend Haskaj, Kryesues i Komisionit për aftësim profesional të noterëve;

- Më datë 05.10.2019, Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Projektin e financuar nga BE "Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve", mbajtën trajnimin me temë " Ekzekutueshmëria e akteve noteriale ", ku z. Aliriza Beshi, Kryetar i Odës së Noterëve dhe z. Shpend Haskaj, Kryesues i Komisionit për aftësim profesional të noterëve, ligjëruan temën: "Ekzekutueshmëria e akteve noteriale sipas Ligjit të ri për Noterinë, klauzola e ekzekutueshmërisë", dhe Z. Sefadin Blakaj, Noter, ligjëroi temën: "Akti noterial dhe përshtatshmëria e detyrimit përmbartimor për ekzekutim; Disa aspekte praktike të ekzekutueshmërisë së akteve noteriale", dhe si i ftuar special në këtë trajnim ishte dhe Zëvendës Kryetar i Odës së Noterëve të Maqedonisë së Veriut z. Naxhi Zeqiri, i cili shpjegoi ekzekutueshmërinë e akteve noteriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Më datë 02.11.2019, Oda e Noterëve në Durrës të Shqipërisë, mbajti trajnimin me temë: "Rastet praktike nga e drejta trashëgimore", me ligjërues z. Naxhi Zeqiri, Zëvendës Kryetar i Odës së Noterëve të Maqedonisë së Veriut, dhe temën "E drejta trashëgimore mbi baza krahasuese me LNSH", me ligjëruese Prof. Dr. Enkeleda Olldashi, znj. Elona Saliaj, Notere dhe z. Fatmir Laçe, Zëvendës Kryetar i Odës së Noterëve të Shqipërisë.

Trajnimet për punëtorë të zyrave Noteriale,

Oda e Noterëve për vitin 2019, në bashkëpunim me Projekti për mbështetje profesionale të lira ligjore dhe OAK-së, mbajti trajnimin për punëtorët e zyrave noteriale me temën: "Lidhja e akteve noteriale". Trajnimi u mbajt për tri ditë radhazi në hapsirat e Odës së Noterëve, me ligjërues z. Sefedin Suljevic, Kryetar i Bordit të Odës së Noterëve të Bosnjë Hercegovinës dhe z. Irhad Habiboviq, bashkëpunëtor i z. Sefedin Suljevic.

Edhe pse gjatë këtyre trajnimeve ka patur mungesa të noterëve, Këshilli Drejtues nuk e ka vlerësuar se këto raste duhet të paraqiten në Komisionin për Arbitrazh dhe Disiplinë, pasi që noterët paraprakisht apo me kërkesë të Këshillit e kanë arsyetuar me shkrim mos prezencën e tyre në këto trajnime.

EVIDENCA E AKTEVE TË HARTUARA PËR VITIN 2019

Komuna	JANAR	JANAR	SHKURT	SHKURT	MAJ	MAJ	PRILL	PRILL	MAJ	MAJ	QERSHORE	QERSHORE	KORRIK	KORRIK	GUSHT	GUSHT	SHITATON	SHITATON	TETOR	TETOR	NENTOR	NENTOR	DHETOR	DHETOR
	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte	Vetëtime	Akte
Pristinë	6164	1862	7770	1741	8131	2033	8341	2093	9728	2234	8148	1784	16330	2339	9542	2428	10866	1935	10133	2287	7272	2063	6310	1943
Prizren	2706	692	2818	623	3092	664	3088	784	3257	832	2862	675	5268	914	3945	972	3402	738	3149	847	2988	713	2765	803
Gjilan	2383	634	2391	566	2605	678	2611	715	2676	733	2391	598	5489	884	3695	903	3693	767	2879	836	2085	631	2838	732
Pejë	1747	669	2304	421	2330	665	2261	706	2017	690	2187	593	4849	899	3448	939	2806	750	2511	809	1891	638	1781	798
Fetisaj	1682	1068	1728	951	2017	1000	1949	1116	2019	1050	2022	932	3587	1228	2945	1401	2182	1169	2358	1431	1710	1006	1654	1109
Gjakovë	1372	398	1703	371	1885	419	1798	504	1789	502	1815	335	4038	520	2474	612	2398	473	2344	545	1301	425	1618	480
F.Korovë	993	562	1152	590	1275	672	1308	616	1258	632	1438	542	2142	665	1747	684	1815	712	1620	739	1378	644	1417	704
Mitrovicë	1236	329	1467	354	1637	417	1739	399	1438	362	1609	341	4877	505	1984	445	2082	396	1625	384	1265	371	1462	432
Lipjan	1081	498	1065	421	1168	501	1774	524	1638	504	1722	529	2122	566	2031	690	1362	519	1336	550	1273	465	937	509
Gencovë	306	139	393	135	447	168	522	157	493	167	333	137	405	197	396	159	395	181	456	217	367	171	330	183
Subotikë	1071	242	909	192	983	240	1293	287	1309	271	883	238	1638	306	1808	387	1077	319	950	318	831	209	1052	317
Podujevë	926	413	868	311	904	357	991	337	1154	306	1148	321	2166	319	1430	365	1357	367	1131	418	864	351	927	395
Vushtrri	1070	436	1154	456	1137	513	1237	462	1064	414	1253	442	2456	549	1534	566	1255	444	1036	560	783	455	812	547
Gjigjovë	1018	321	881	260	1124	346	1119	319	1137	366	987	308	1881	330	1405	327	1312	337	979	337	799	286	832	357
Viti	873	227	623	210	640	239	708	237	639	247	704	230	1692	335	1019	257	778	272	689	303	542	280	544	296
Orilq	160	141	194	123	206	134	215	163	262	146	232	138	423	181	201	129	255	160	272	170	159	143	208	140
Kamenicë	2	39	1	32	x	49	x	46	x	62	x	47	x	61	x	75	x	52	x	85	x	46	x	49
Mamutë	120	38	140	44	97	32	x	1	15	17	33	24	9	9	4	5	1	1	11	5	6	4	3	3
Mallitovë	496	197	551	141	566	158	46	19	62	39	94	53	80	36	79	44	27	33	69	45	34	20	45	46
Kllukor	4	9	5	10	x	5	1	9	10	4	1	3	3	6	2	11	3	15	4	10	6	8	6	11
Shitue	338	111	305	79	332	106	304	114	254	97	142	49	612	118	557	187	386	127	355	118	239	115	315	135
Dreghsh	420	35	318	28	304	35	329	49	287	47	359	48	679	106	834	213	414	78	345	77	283	43	251	61
Novobërdë	119	80	71	78	83	75	229	131	147	105	126	94	103	126	99	126	69	105	119	81	82	72	124	48
Ing	4	43	5	37	6	52	28	83	23	60	40	95	56	107	54	124	26	66	30	98	12	60	18	85
Dëran	437	114	325	113	323	112	626	124	612	149	532	112	894	134	830	154	489	150	483	155	302	138	513	349
Shëtrpë	78	40	85	24	109	34	116	41	107	34	140	45	183	58	131	40	113	49	146	63	115	48	117	53
Kërnuk	345	135	352	113	368	146	351	152	230	116	238	127	887	205	593	187	414	149	363	149	239	120	325	169
Rahovec	595	146	394	146	464	147	547	183	533	168	520	142	690	161	769	198	505	156	440	174	432	151	466	193
Klinë	563	165	489	139	465	139	514	174	466	148	543	159	1116	222	669	210	547	171	463	184	357	154	420	205
Parech	6	5	5	4	19	11	12	11	8	8	10	9	28	20	24	17	21	14	6	4	2	8	2	10
Ranilluk	5	6	6	8	3	6	5	10	9	12	16	14	12	18	77	19	26	14	12	13	9	10	9	10
Junik	60	17	23	6	48	8	38	16	50	10	55	6	40	13	50	13	36	12	22	18	16	14	23	14
Leposaviq	x	x	x	1	x	6	x	3	x	1	x	1	1	2	x	1	x	1	x	3	x	6	x	4
Zecan	x	x	x	2	x	3	x	2	x	3	x	x	x	2	x	x	4	3	x	4	x	6	x	1
Zahin Potok	x	x	x	1	x	x	x	x	x	3	x	x	x	x	x	1	x	1	x	x	x	1	x	1

Tabela e sipërshënuar tregon numrin e akteve të hartuara/përpiluara për vitin 2019, numrin e vërtetimeve noteriale dhe akteve noteriale në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2019, gjithsej janë përpiluar/hartuar 563,114 akte, prej tyre 435,115 vërtetime noteriale si dhe 127,999 akte noteriale. Shërbimi Administrativ i Odës të dhënat në lidhje me vërtetimeve noteriale dhe akteve noteriale i ka siguruar përmes deklaratave të obligueshme mujore të pranuar nga noterët.

Prishtinë, 10.01.2020.

Kryetari i Odës së Noterëve

Aliriza Beshi